

Abstrakti

Procesi i zgjedhjes së qeverisë është një proces dinamik sekondar, nga i cili paraprihet nga zgjedhjet e lira parlamentare që sigurojnë një demokraci të mirfilltë parlamentare.

Proces dinamik për arsye se procesi i krijimit të qeverisë gjithmonë interferohet nga faktori kohë, që nga momenti i certifikimit të zgjedhjeve, nominimit nga ana e institucionit të presidencës, e deri te momenti i formimit dhe votimit në parlament të qeverisë, ku secili veprim duhet të bëhet brenda një intervali kohorë dhe një rregullore të caktuar në mënyrë që të jetë legjitime si organ ekzekutiv. Ndërsa proces sekondar për arsye se zgjedhjet parlamentare janë parakusht i krijimit të institucioneve në një demokraci parlamentare siq janë konsistitium i parlamentit dhe formimi i qeverisë, që do të thotë spari mbahen zgjedhjet më pastaj formohen institucionet.

Edhe pse formimi i qeverisë kalon nëpër gjithë këto etapa egzistojnë raste kur qeveria gjatë votimit apo përzgjedhjes së kandidatit për kryeministër bënë shkelje kushtetuese, nga të cilat palet e interesuara mundë ta kontestojnë procesin e zgjedhjes (votimit) në gjykatën kushtetuese ku si rezultat mundë të vie deri te shpallja e një qeverie jo legjitime dhe në kundërshtim me kushtetutën, në një situatë të rregullt shkohet në zgjedhje të reja.

Raste të tilla ka në shumë vende të botës me një demokraci moderne dhe një sistem parlamentar të shëndetshëm të qeverisjes edhe vendi ynë ka pas fatin ti provojë rastet të tilla kur gjykata kushtetuese i ka shpallur si qeveri jo legjitime dhe në kundërshtim me kushtetutën.

Fjalët kyçe: Qeveria, Procesi i Zgjedhjes së Qeverisë, Kushtetuta, Gjykata Kushtetuese, Kontestimi i Qeverisë.